

VENDIM
Nr.127, datë 2.2.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË MALIQ, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Maliq, të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 964 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Maliqit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
6-17	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
27-29	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
30-25,566-572	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile	Në pronësi
18-26	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
239-254	Shërbim funeral	Në pronësi
3,140-154,155-159,255,257-272,274-282,285,286,288-291,295-304,309-312,313-317,320-323,324-334,335-409,410-415,416-470,473,475-479,480-485,487,488-492,495,496,504,506,536,564,584,586,592-898	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, troje të zëna, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
52-72,5,94-102,104-105,273,283,287,497-501,505,507,510-523,525,527-530,538,539,541,546,555,556,576,578	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
256,284,292,293,294,308,318,319,471,472,474,486,493,494,502-503,508-509,524,526,531-535,537,540,542-545,547-551,553-554,557-563,565,573,577,579-583,585,587,588,589-591	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
106,162,163,165,167,169,171,173,175,176,178	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
900-912	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
161,164,166,168,170,172,174,177	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi